



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/125;
Datë: 24.02.2017 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-110/422	1	28.02.2017

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22.1 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut dhe pikës V të vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut numër 02/19, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 24.02.2017 nxjerrë:

VENDIM

për miratimin e

Raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2016

- I. Me këtë vendim miratohet Raporti i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2016/në tekstin e mëtejme raporti/.
- II. Raporti është dokument publik dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i miratuar në kuvend.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-371/17;
Datë: 24.02.2017 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Fert.	Nr.i faq	Data
2-479/17	3	28.02.2017

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE PËR VITIN 2016

Junik, shkurt 2017

Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Inspektion në tekstin e mëtejshëm KSHPMI gjatë vitit 2016 ka mbajtur gjithsejtë gjashtë (6) mbledhje.

Gjatë këtyre mbledhjeve kemi pasur çështje të rëndësishme për shqyrtim që kanë ndihmuar shumë tek anëtarët e komitetit që të kenë një informim të hollësishëm në lidhje me fushën e shërbimeve publike për të cilën është përgjegjës KSHPMI.

Dhe po ashtu mendojmë se duke shfrytëzuar pikërisht mbledhjet e komitetit kemi ndikuar si trup ndihmës e kuvendit komunal që të ndikoj direkt në punën e drejtorisë komunale të Shërbimeve Publike, duke nxjerrë nga këto takime sugjerime, udhëzime, ide, propozime dhe rekomandime që kanë ndikuar në një masë në përmirësimin e punës së shërbimeve publike në përgjithësi në komunën e Junikut në raport me praktikën e kaluar.

Më poshtë po i paraqesim disa fusha me të cilat jemi marrë gjatë këtij viti dhe kemi dhënë ndihmesën tonë në fushën e shërbimeve publike që ato të jenë sa më kualitative aq sa ne kemi kompetencë në këtë fushë.

Plani vjetor i punës së KSHPMI për vitin 2016 ishte:

- Hartimi dhe procedimi në kuvend i raportit të punës së KSHP-së për vitin 2015;
- Informatë mbi planin vjetor të prokurimit publik për vitin 2016 për DSHPMI;
- Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave;
- Informatë mbi raportin e performancës;
- Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit;
- Informatë mbi punën njëvjeçare të DSHPMI;
- Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin veror;
- Informatë për mbrojtje kundër zjarrit;
- Informatë mbi zbatimin e planit të mobilitetit;
- Përgatitjet për implementimin e planit të mobilitetit në komunën e Junikut;
- Përgatitja e planit të punës së KSHP-së për vitin 2017;
- Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror;
- Informatë rreth grupit të punës për plotësim ndryshim të rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa;
- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KSHP-së për vitin 2017;
- Informatë mbi menaxhimin e pyjeve të cilat janë nën mbikëqyrjen e Komunës së Junikut;
- Informatë mbi veprimtarinë e auto taksive; dhe
- Informatë mbi planin e rrezikshmërisë.

Nga çështjet e trajtuar më lartë shihet se ne si komitet jemi marrë me shumë fusha që na përkasën neve si komitet dhe në mbledhjet e komitetit janë diskutuar në mënyrë të hollësishme të gjitha çështjet që kanë qenë në diskutim.

Këto takime të komitetit kanë qenë një arenë e diskutimeve profesionale të hollësishme në mes të komitetit, administratës së drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe aktorëve të drejtpërdrejt të situatave të caktuara, nga të cilat takime kanë dalë rekomandime, sugjerime dhe udhëzime të nevojshme në funksion të një funksionimi më cilësor të shërbimeve në komunën tonë.

Temat që janë diskutuar në këto takime kanë qenë në funksion të një transparence të plotë të punës së administratës komunale dhe si komitet kemi ndihmuar mendoj mjaftë në këtë drejtim.

Po ashtu ne si komitet kemi nxjerrë në agjendë të kuvendit komunal me 2016 disa çështje për diskutim nga të cilat takime kanë dalë rekomandime për të ndihmuar DSHPMI.

Në përgjithësi mendoj se ne si trupë ndihmëse e kuvendit komunal kemi kontribuar mjaft mirë që të kemi përmirësim kualitativ në shërbimet publike në komunën tonë. Dhe për këtë angazhim unë falënderoj anëtarët e komitetit për një punë të mirë si dhe Drejtorinë për Shërbime Publike.

Sfidat dhe dështimet

Gjatë vitit 2016 KSHP ka pasur shumë sfida, sfidë ishte edhe bashkëpunimi herë pas here me zyrtarët e drejtorisë sepse jo gjithmonë treguan gatishmëri për bashkëpunim, jo gjithmonë na ofruan informata të kërkuara.

Po ashtu dështim konsideroj mos sigurimin dhe rregullimin e një deponie për hedhjen e materialeve inerte çka e cila do të ndihmonte shumë në mos ndotjen e ambientit kryesisht përgjatë segmentit të rrugëve që të shpien në Junik.

Po ashtu dështim konsideroj edhe mos kompletimin e KSHP-së me një anëtar, ndoshta këtu ishte edhe çështje politike plotësimi me një anëtar nga radhët e subjektit politik Vetëvendosje.

Jam i vetëdijshëm se këtu nuk janë paraqitur të gjitha punët e kryera dhe të gjitha temat e diskutuara, si dhe ka mundur të punohet edhe më tepër. Mbetet që në të ardhmen që sfidat e lartpërmendura të diskutohen gjatë vitit 2017 në mënyrë që puna e këtij komiteti të jetë më efikase.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues

